



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS  
MUNICIPALITY OF KLINA  
OPŠTINA KLINA



[www.komuna-klina.org](http://www.komuna-klina.org)

Kuvendi i Komunës Klinë  
Komiteti për Politikë dhe Financa  
01Nr 06-32986 /22  
Klinë,dt: 21.09. /22

## PROCESVERBAL

Nga mbledhja e VI-të e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur, më 14.7.2022, me fillim nga ora 9:00, në sallën e Kuvendit të Komunës.

Mbledhjen e hapi Kryesuesi, z. Fadil Gashi, i cili përshëndeti të gjithë anëtarët e Komitetit, drejtorët dhe të pranishmit të cilët ishin pjesëmarrës në mbledhje të KPF-së.

Si pika shtesë të rendit të ditës hynë tri kërkesa:

**Kërkesa 1.** Nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit për iniciimin e procedurave për shpronësimin e pronës private e cila është në interes publik për ndërtimin e rrugës në fshatin Dresnik.

**Kërkesa 2.** E parashtruar nga Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim për shqyrtimin e listës së hartuar nga komisioni komunal për verifikimin e obliguesve të qirave komunale, shfrytëzues të banesave të cilat janë pronë e komunës së Klinës të cilat shfrytëzohen nga banuesit social dhe nga zyrtarët publik.

**Kërkesa 3.** E parashtruar nga Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim për ndarjen e mjeteve në shumë prej 10,000.00 euro nga subvencionet e zyrës së kryetarit, të ndahen për mbulimin e nevojave të DKRS-së, pagesa për shpenzimet të cilat nuk kanë mundur të mbulohen për festivalin folklorik i "I këndojmë Lirisë" dhe për subvencionim të OJQ-ve.

Më pas, Kryesuesi prezantoi rendin e ditës:

1. Arsyetimi i mungesave,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
3. Shqyrtimi i raportit financiar për gjashtëmuajorin e parë 2022,
4. Shqyrtimi i raportit të auditimit të jashtëm për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Klinës për vitin 2021,
5. Shqyrtimi i propozim-vendimit për ri-alokim të mjeteve buxhetore (ref.drejt.fin),
6. Shqyrtimi i kërkesave të arritura për Komitetin për Politikë dhe Financa për muajin Qershor-Korrik 2022,
7. Të ndryshme.

Kryesuesi hapi debat rreth rendit të ditës!

Pasi nuk kishte ndonjë vërejtje apo sugjerim, me 7 vota PËR, u miratua rendi i ditës.

**Pika 1. Arsyetimi i mungesave.**

Fadil Gashi, Kryesues: Të gjithë anëtarët e Komitetit janë prezent.

**Pika 2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.**

Fadil Gashi, Kryesues: Nëse ka dikush diçka rreth procesverbalit nga seanca e kaluar, urdhëroni!

Pasi nuk kishte ndonjë vërejtje apo sugjerim, Kryesuesi hodhi në votim dhe me 7 vota PËR, u miratua procesverbali nga mbledhja e kaluar.

**3. Shqyrtimi i raportit financiar për gjashtëmuajorin e parë të vitit 2022.**

Fadil Gashi, Kryesues: Ju raportin veç e keni, por sigurisht Ajeti e ka një prezantim të shkurtër. Urdhëro, Ajet Sejdiu!

Ajet Sejdiu: Faleminderit Kryesues, përshëndetje për ju, gjithë stafin dhe ju anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa! Siç e shihni, e potencoi edhe Kryesuesi se raportin financiar e kemi obligativ si Drejtori në bazë të Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, të cilën e kemi kryer në afatin kohor të paraparë. Rreth raportit nuk po flas më shumë se i keni para vetes gjitha të hyrat, gjitha shpenzimet, pra, gjithë procesin buxhetor. Periudhën gjashtëmuajore e keni para vetes dhe më shumë s'kisha folur, ndoshta në Kuvend duhet pak më tepër, por për Komitet, kaq.

**Fadil Gashi, Kryesues:** Faleminderit, unë po hap debat!

**Tunë Dedaj:** Po Kryesues, unë po e shoh që këtu është participimi i qytetarëve 21.000.00 euro, kam pasur dëshirë të pyes drejtorin se kush kanë qenë këta që kanë participuar?

**Ajet Sejdiu:** Kanë participuar qytetarët për serra dhe për dy projekte që i ka zhvilluar Drejtoria e Bujqësisë, pra, shumica kanë qenë për serra.

**Mendehie Duraku:** Faleminderit Kryesues, përshëndetje për të gjithë! Unë desha ta pyes drejtorin vetëm tek participimi tek çerdhja. Gjashtëmujorin e vitit 2021 ka qenë 11 mijë e diçka, tash gjashtëmujorin e vitit 2022 është 13.000.00, veç desha të pyes përse kjo rritje, a nga numri i fëmijëve më shumë në çerdhe apo përse?

**Ajet Sejdiu:** Faktikisht vet ju përgjigje pyetjes se numri i nxënësve e dikton edhe pjesëmarrjen, participimin. Kjo është gjendja se na kanë dërguar Drejtoria e Arsimit edhe ashtu është numri.

**Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të raportit financiar për gjashtëmujorin e parë 2022, rekomandoi që të kalojë për shqyrtim në Kuvend.**

#### **4. Shqyrtimi i raportit të auditimit të jashtëm për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Klinës për vitin 2021.**

**Fadil Gashi, Kryesues:** Unë po besoj se raporti veç ju ka shpërndarë edhe juve, sigurisht që do ta marrin edhe anëtarët tjerë të Kuvendit. Ne e kemi edhe obligim ligjor ta shqyrtojmë raportin e auditorit, por është pjesë edhe e performancës, ndaj ne jemi me kohë, ne veç në momentin që e kemi marr përnjëherë e kemi proceduar në Komitet edhe në Kuvend. Me thënë të drejtën edhe pika tjetër e banesës që ne e miratuam si shtesë sot, lidhet në raport të auditorit dhe auditori e ka përmend si të gjetur dhe komuna ka marr obligime për t'i sanuar ato të gjetura, prandaj edhe kjo është pjesë e atyre rekomandimeve, por gjithsesi unë po hapi debat rreth raportit.

**Ajet Sejdiu:** E tha Kryesuesi se veç e keni marr raportin e auditorit, jemi obligativ në bazë të Ligjit mbi auditimin ta prezantojmë në Kuvend. E keni parë se këtë vit kemi dymbëdhjetë rekomandime; tetë janë nga rekomandimet e mëparshme dhe katër janë rekomandime të reja, por është me rëndësi që pasqyrat financiare janë në përputhshmëri të plotë me normat ndërkombëtare dhe me Ligjin mbi auditimin, do të thotë, pasqyrat financiare të cilat e pasqyrojnë krejt zhvillimin e procesit të auditimit, ato janë në rregull. Normal që kemi rekomandime por ato rekomandime më tepër janë te natyrës administrative të cilat kemi me pas për gjitha vitet dhe janë p.sh., konkretisht rekomandime të cilat po filloj nga Drejtoria e Financave p.sh., shkalla e mos inkasimit në përputhshmëri me Ligjin mbi menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, kemi rekomandime tjera p.sh., për disa procedura administrative këtu te OJQ-të të cilat veç jemi duke i zbatuar, por në procedura të vogla administrative i kanë konstatuar si rekomandim dhe ne e kemi përpiluar Planin e Veprimit për zbatimin e atyre rekomandimeve. Jemi në fazën fillestare dhe do t'i zbatojmë rekomandimet sepse jemi pajtuar me gjitha çka i ka dhënë auditori por esenca është se pasqyrat financiare janë në përputhshmëri të plotë me ligjin

mbi auditimin dhe me ligjet ndërkombëtare të kontabilitetit, kaq!

**Fadil Gashi, Kryesues:** Faleminderit drejtor, unë po hap debat rreth raportit të auditorit nëse ka dikush, urdhëroni!

**Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të raportit të auditorit të jashtëm për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Klinës për vitin 2021, pa ndonjë vërejtje, me 7 vota PËR, rekomandoi që të kalojë për shqyrtim në Kuvend.**

#### **5. Shqyrtimi i propozim-vendimit për ri-alokim të mjeteve buxhetore (ref.drejt.fin).**

**Fadil Gashi, Kryesues:** Urdhëro, Ajet Sejdiu!

**Ajet Sejdiu:** Po Kryesues, është një propozim që ja kemi bërë Kuvendit dhe Komitetit për Politikë dhe Financa për një projekt që u zhvillua në vitin 2021 në fshatin Dobërdol, por në bazë të ofertave që janë paraqitur nga operatorët ekonomik, çmimi ka dalë më i lirë dhe është kryer puna në tërësi. Tash ato mjete se na kanë mbetur nga ky projekt ne duhet t'i orientojmë në bazë të Ligjit mbi menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, një projekt njëjtë do të thotë në kapitale se nuk mund të bëjmë transfere ose ri-alokim në projekte prej mallrave dhe shërbimeve në kapitale ose anasjelltas, por një projekt që drejtoria përkatëse, Drejtoria e Urbanizmit ka propozuar që këto mjete të dedikohen në ato dy projekte, në ato dy kode, pra janë projekte kapitale prej 16.300.00 euro dhe të dedikohen pra në projektin në qytetin e Klinës dhe në rrugën deri në Zajm që ka nevojë ai projekt për mjete shtesë, për të mos na humbur kjo procedurë administrativo-financiare edhe ju kemi bërë propozimin si organ autoritativ dhe kompetent për marrjen e vendimit të tillë, faleminderit!

**Fadil Gashi, Kryesues:** Faleminderit Ajet, arsyeshmërinë e propozimit dhe të kërkesës më duket që e morëm, nëse ka dikush, urdhëroni!

**Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të kërkesës nga Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim, me 7 vota PËR, rekomandoi që kërkesa për ri-alokim të mjeteve buxhetore të kalojë për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.**

#### **6. Shqyrtimi i kërkesave të arritura për Komitetin për Politikë dhe Financa për muajin Qershor-Korrik 2022.**

**Fadil Gashi, Kryesues:** Kemi kërkesën e parashtruar nga Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjente, e cila kërkon që të ndahen mjete financiare në shumë rreth 20,000.00 euro, me anë

të të cilave kanë destinim blerjen e pajisjeve teknologjike në procedurë të rregullt të prokurimit për nevoja të Stacionit Policor në Klinë. Ne kemi dërguar propozim-vendimin për ndarjen e këtyre mjeteve buxhetore për konsultim paraprak të ligjshmërisë në MAPL.

**Tunë Dedaj:** Unë mendoj se duke e marr parasysh që kjo i takon ministrisë për t'i blerë gjitha ato, nuk i takon komunës dhe duke e ditur se kjo qeveri pare ka mjaft, se nuk i ka shfrytëzuar në punë askund, ka qenë mirë që ata ta blejnë, po nëse ata nuk e blejnë, atëherë unë jam që këtë punë ta kryejë Kuvendi i komunës.

**Fadil Gashi, Kryesues:** Ne kemi vullnet për të ndihmuar por ne po duhet ta ndjekim kushtin ligjor pa ra ndesh me procedurat sepse nëse ne marrim vendim, pastaj procedurat e tenderit janë procedura tjera, dmth krejt shuma është 20.000.00 euro e këtij projekti që ne po pretendojmë të investojmë në policinë e Klinës dhe janë ato pajisje që nuk do t'i shërbejnë veç policisë por gjithë qytetarëve dhe neve bashkë me ta. A ka dikush tjetër?

**Komiteti për Politikë dhe Financa, me 7 vota PËR, rekomandoi që kërkesa të kalojë në Kuvend, me kusht që nëse deri në seancë Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal e konfirmon si të ligjshëm ndarjen e këtyre mjeteve buxhetore të shqyrtohet në Kuvend.**

## 7. Të ndryshme.

**Fadil Gashi, Kryesues:** Tek të ndryshmet i kemi tre kërkesa të reja që na kanë ardhur:

### Kërkesa 1.

E parashtruar nga Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim për ndarjen e mjeteve në shumë prej 10,000.00 euro nga subvencionet e zyrës së kryetarit, të ndahen për mbulimin e nevojave të DKRS-së, pagesa për shpenzimet të cilat nuk kanë mundur të mbulohen për festivalin folklorik i "I këndojmë Lirisë" dhe për subvencionim të OJQ-ve.

**Mendehie Duraku:** Faleminderit Kryesues, këtu po thotë që këto mjete të shfrytëzohen edhe për shpenzimet e festivalit "I këndojmë lirisë". Siç e dimë ne kemi marr një vendim në Kuvend që ka qenë diku vlera prej 20.000.00 euro, po veç desha me ditë nëse, a s'kanë mjaftuar ato para që i kemi marr në atë vendim apo pse edhe OJQ-të të paguhen, për çfarë shpenzime paguhen OJQ-të dhe kishte qenë mire ta kemi një raport nga drejtoria për të parë se si janë shpenzuar dhe pse po ju duhen mjete prapë, kaq!

**Fadil Gashi, Kryesues:** Ne edhe në seanca tjera në mandat të kaluar kemi kërkuar raport, jo vetëm për këta por gjithë të tjerët është mirë ta sjellin raportin dhe e kanë edhe obligim ligjor kushdo që subvencionohet prej komunës. Komuna nuk guxon të jap subvencion të ri pa e sjellë raportin se çka ka bërë me t'parin edhe është mirë të kërkojmë edhe me na ardh, absolutisht po

pajtohem.

**Ajet Sejdiu:** Pajtohem me pyetjen e këshilltares, ju e dini që me planifikimin e buxhetit 2021 për vitin 2022, janë planifikuar për OJQ-të 60.000.00 euro dhe kjo shumë është shpenzuar nga Drejtoria e Kulturës sepse festivali e ka tejkaluar shumën që ju e keni ndarë prej 20.000.00 euro. Ndoshta kanë ndikuar çmimet që janë rritur në tregun mbarë botëror dhe në vendin tonë por me siguri siç e tha kryetari i Kuvendit, obligative është drejtoresha e Kulturës që të vijë me një raport financiar dhe t'i paraqes të gjitha dukuritë financiare si janë zhvilluar edhe në festival por edhe për OJQ-të. Kështu që, drejtoresha ka bërë një kërkesë në Drejtorinë e Financave prej subvencioneve të kryetarit, do të thotë prej të njëjtës kategori buxhetore me ju ndarë 10.000.00 euro që është kompetent Kuvendi, ju që jeni kompetent se përndryshe ne nuk mujm me egzeptu në thesar nëse s'merret një vendim i tillë, por raportin financiar plotësisht pajtohem që ajo duhet me ardh me raport të veçantë edhe ta paraqes raportin si janë zhvilluar procedurat e harxhimit të këtyre mjeteve në festival.

**Mendehie Duraku:** Veç edhe diçka, se di a kuptova mire, veç ma sqaron, ju thatë se dhe 60.000.00 euro i ka shpenzuar, edhe 20.000.00 që ka qenë vendimi i kanë shpenzuar 80.000.00, edhe 10.000.00 po i kërkon tash nga subvencionet e kryetarit, edhe 90.000.00 euro po thua a?

**Ajet Sejdiu:** Jo, jo, shiko 90.000.00 jo se 60.000.00 ju kanë ndarë me planifikimin e buxhetit , ajo për shembull veç një OJQ ja ka marr 32.000.00 euro, do të thotë klubi futbollistik "Dukagjini", kjo i ka shpenzuar në festival këto 10.000.00 se për OJQ-të kanë qenë të ndara po tash kanë mbetur një pjesë e OJQ-ve sepse i ka shpenzuar drejtoresha për festivalin, kjo është.

**Tunë Dedaj:** Nëse ju kujtohet juve, unë pata propozuar që Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport të ju ndahet shuma me kohë prej 150.000.00 euro e mos me ardh në këtë situatë tash gjithmonë me marr nga zyra e kryetarit edhe me ja marr 10.000.00 euro sot e 10.000.00 euro ma vonë, por me i pas paraparë dhe planifikuar se aty dihet sa OJQ-të marrin pjesë për me ju shpërndarë është pak, mirëpo unë nuk jam me ju ndarë asnjë cent se drejtoria nuk na sjell raportin ku kanë shkuar këto mjete, kush i ka marr edhe ndarja e mjeteve që janë ndarë më së shumti kanë marr 32.000.00 euro që thatë klubi i futbollistëve "Dukagjini", është e padrejtë por është mirë gjitha klubet në mënyrë të barabartë të ju ndahen mjetet.

**Ajet Sejdiu:** Shiqo Tunë, për në mënyrë të barabartë nuk mund të ndahen të gjitha se aty është komisioni. Rregullorja e Ministrisë së Financave shumë kjoartë i definojnë qysh me i ndarë, do të thotë kompetent për ndarjen është komisioni në bazë të Rregullores që e formon zyrtari kryesor Administrativ, dmth ne e kemi prej të njëjtës kategori si këtu 10.000.00 euro. Ju Kuvendi keni të drejtë veç me u definu , me ja ndarë dhe me i mbuluar shpenzimet e festivalit, se për OJQ-të kanë qenë të dedikuara 60.000.00 euro me planifikimin e buxhetit dhe me miratimin në këtë Kuvend janë ndarë 60.000.00 euro, por tash kjo i ka shpenzuar 10.000.00 prej tyre dhe është mbetur borxh ndaj disa OJQ-ve të vogla që është e padrejtë mos me jua bërë një gjë të tillë, por ne kryetarin po e dëmtojmë në buxhet në subvencione sepse ka edhe ai obligime të jashtëzakonshme, p.sh., veç lindjet edhe vdekjet ja marrin një pjesë të konsiderueshme, por ai ka pajtuar edhe ne veç kemi me marr atë vendim për shkak të procedurave të pagesave, sepse e

njëjta kategori buxhetore është. Ne mund të shkojmë edhe drejt nga zyra e kryetarit po thesari na bën telashe se është ligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, e definon në mënyrë të qartë qysh me u shpenzuar, kjo është qëllimi, do të thotë janë mbetë në festival edhe i kanë shpenzuar 60.000.00 që janë aprovuar me buxhetin që e keni aprovuar ju vitin e kaluar për këtë vit.

**Tunë Dedaj:** Unë e thash edhe përpara se pse mos ta planifikojnë më shumë kur ne dihet që më shumë është kërkesa më e madhe, me kohë të planifikohet një shumë më e madhe se unë pata propozuar me u bërë 150.000 .00 euro, do të thotë që nuk e shoh kurrë të arsyeshme që mund ta arsyetosh, të thuash se duhet me i marr “Klubi i Dukagjinit” 32.000.00 euro e të gjitha OJQ-të tjera që janë 28.000.00 . Kjo për mua është e paarsyeshme gjithmonë edhe komisioni që ka bërë ndarjen unë mendoj që ka bërë në mënyrë të gabuar edhe ka gabuar shumë rëndë.

**Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të kërkesës së parashtruar nga Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim, me 7 vota PËR, rekomandoi që kërkesa për ndarjen e mjeteve buxhetore nga subvencionet e zyrës së kryetarit të kalojë për shqyrtim dhe miratim në Kuvend, me kusht që në Kuvend të sjellët raporti i shpenzimeve për mbajtjen e festivalit folklorik “I këndojmë lirisë”.**

## **Kërkesa 2.**

**Kërkesë e parashtruar nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit për iniciimin e procedurave për shpronësimin e pronës private në emër të Fatlum (Miftar) Deliu, parcela me Nr. P-71010027-00144-3 ZK Dresnik, ku nga kjo parcelë do të ndahen dhe do të shpronësohet sipërfaqja prej 285.23 m<sup>2</sup> e cila është në interes publik dhe shërben për ndërtimin e rrugës në fshatin Dresnik.**

**Fadil Gashi, Kryesues:** Ne veç e rekomandojmë për Kuvend edhe ja mundësojmë ekzekutivit me ja fillu procedurat e shpronësimit, do të thotë ne nuk jemi duke marr vendim për shpronësim por ne veç po e autorizojmë kryetarin, ekzekutivin në këtë rast sepse procedurat për shpronësim sipas Ligjit të shpronësimit qartë i determinon hapat që duhet për një shpronësim, prandaj ne veç marrim vendim për iniciim edhe e autorizojmë ekzekutivin me ja fillu procedurave , kjo është as më shumë as më pak. Urdhëro, Tunë Dedaj!

**Tunë Dedaj:** Me thënë të drejtën mua shumë po më duket mënyrë e arsyeshme sepse askujt nuk është mirë të ja marrësh pronën dhe të mos ja kompensosh. Unë në rrugën e Dresnikut kam parë dy-tre pengesa edhe pajtohem, të fundi i fundit nuk duhet shumë të pyesësh për pronarin e tokës por të ja kompenzosh edhe të ja marrësh sepse është për nevojën të përgjithshme, këtë e pata.

**Fadil Gashi, Kryesues:** Me thënë të drejtën unë po pajtohem me ju, Tunë, sepse më mirë është kështu me hyj nëse ka mundësi të shpronësimit sepse ne vlerën tash saktë ndoshta s’mund ta interpretojmë Ligjin për shpronësim por është një komision i pavarur as i komunës as i palës që e vlerëson, ata janë të certifikuar, se di a ka në Kosovë kështu por po pretendojmë për po. Pra më mirë është kështu të fillojnë me shpronësim sesa të ja shtrojnë asfaltin e pastaj ai t’i dërgojë në

gjykatë, kështu nuk mundet sepse pasojat janë më të mëdha. A ka dikush tjetër?  
Atëherë, kush është për?

**Komiteti për Politikë dhe Financa pas shqyrtimit të kërkesës, me 7 vota PËR, rekomandoi që kërkesa e drejtorisë për inicimin e procedurave të shpronësimit të pronës private me interes publik të kalojë për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.**

**Kërkesa 3.**

**Kërkesë e parashtruar nga Drejtoria për Financa Ekonomi dhe Zhvillim për shqyrtimin e listës së hartuar nga komisioni komunal për verifikimin e obliguesve të qirave komunale shfrytëzues të banesave të cilat janë pronë e komunës së Klinës, të cilat shfrytëzohen nga banuesit social dhe nga zyrtarët publik.**

**Fadil Gashi, Kryesues:** Në seancë e kemi miratuar Planin tre vjeçar dhe është pak numri i madh, aktualisht në pronësi të komunës janë gjithsej 117 njësi banesore në Klinë dhe është mirë ta dimë se si shfrytëzohen edhe ka sa shfrytëzohen. Komisioni pak e ka bërë një gabim pa dashje ndoshta, sepse ka rëndësi shumë koha e lidhjes së kontratës se këtu kontratën nuk e lidh të njëjtën kohë edhe ka pasur infrastrukturë tjetër ligjore, për këtë është. Tash ata se i kanë lidhur më herët duhet të harmonizohen edhe ligjet e reja ose udhëzimet, aktet tjera të reja që e rregullojnë çështjen e banimit se nëse i referohemi, unë shkurt e pash raportin po është i kompletuar edhe me këto që thotë qiratë nuk janë të njëjta po edhe që thotë sipas udhëzimit dhe sipas ligjit për banim social, thotë komuna duhet të ndajë edhe bonuse, duhet të ju ndihmojë edhe në qira njerëzve që s'kanë. Ne e kemi obligim për t'ja marr qiranë po ne e kemi obligim edhe të ju ndihmojmë në qira në të njëjtën kohë, vetëm se ne duhet të nxjerrim një regjistër të saktë për njerëz tamam nevojtarë, por jo njerëzve që kanë mundësi ta paguajnë qiranë. Pastaj janë statusi i dy llojeve të banesave: banesat që janë për zyrtarë publik dhe banesat sociale, këto mos të na përzihen. Unë po besoj që ky Komitet është mirë me marr vendimin e rekomandimit për seancë edhe me rekomandu seancën për të nxjerr vendim edhe për ta autorizuar kryetarin në ndërtim të kontratave. Kontratave tash bëhen me ligjet aktuale, me aktet ligjore dhe nënligjore që janë aktuale edhe sanohen gjitha ato kontratat e mëparshme, për banesat tjera se janë në pronësi të komunës dhe nuk kanë konteste të tjera, tash është ligji për shitjen e banesave edhe është mirë me rekomandu kryetari, por fillimisht aty ligji parasheh cilët kanë të drejtë me ble banesa edhe tash është ndryshuar ligji, për hatër të afatit ky ligj për shitjen e banesave ju ka vazhduar afati sepse ju ka skaduar edhe tash për me qenë më të saktë, më 10 mars 2022 është nënshkruar, është dekretuar nga presidentja Vjosa Osmani. Do të thotë ndryshimi i ligjit që ju ka shtuar afati edhe tash komuna në bazë të këtij ligji për një pjesë të banesave ka të drejtë të shkojë në procedurën e shitjes, privatizimit edhe ka mundësi që t'i bëjë dy të mira: njëra krijon të hyra prej shitjes dhe e dyta sa jua merr qiranë më shumë ka me marr tatimin pronë tani, se kur privatizohet ai ka me hy tatim prone edhe ka me marr tani në vazhdimësi të hyra prej tatimit në pronë, dmth se duhet me pa në këto dy kënde, rekomandimi i parë është për këto sociale me fillu edhe me i nënshkruar kontratat qysh ka rekomanduar komisioni, po neve na vyen mi dhanë mbështetje ekzekutivit, në

këtë rast kryetarit, se ai udhëheq, dhe pjesën e dytë, rekomandimin e dytë me dhanë për këtë pjesën tjetër të banesave duke e respektuar ligjin, se di a jam i qartë. Për dy statuse të banesave mos me i përzij njëren me tjetrën, po ata që s'kanë nevojë si e paska konstatuar komisioni realisht, dhanë për dhanë me qira, e jep komuna, ma s'ja jep ai që ja kemi dhanë tij e ai tash me ja marr qiranë tjetërkujt, kaq e thjeshtë është me dashtë me e kuptu. E paskeni edhe ju edhe unë raportin, besoj se e marrin edhe anëtarë tjerë të Kuvendit edhe e marrin edhe regjistrin, unë kam biseduar edhe me kryetarin edhe me drejtorin, po bisedoj edhe me ju, është mirë edhe njëherë mos me ju hy në hak këtyre se qenka si rekomandim, me ja tërheq të drejtën e shfrytëzimit këtyre, se po e shoh është mirë edhe njëherë me komuniku me këta njerëz, me komuniku edhe me thanë kështu është gjendja, për pjesën tjetër janë dy rekomandime: njëra me i dhanë autorizim të vazhdimit të kontratave me kushte të reja, me kërkesa te reja sipas ligjit edhe një prapë sipas ligjit për pjesën tjetër të banesave me status tjetër le t'fillojë procedura e shitjes së tyre. Këto dy rekomandime janë, e para për banesë sociale dhe e dyta është duke ju referuar ligjit për shitjen e banesave ku ekziston e drejta, ti së pari duhet të kesh të drejtë, me qenë sipas ligjit a ke të drejtë me ble banesën dhe nëse ke të drejtë ti fillon procedurën, nëse s'ke të drejtë ti se fillon fare procedurën.

**Bledar Berisha:** Desha një pyetje se unë në seancën e kaluar s'kam qenë, sa i përket raportit desha të pyes a është një raport që përfshin banesat kur janë ndarë nga komuna apo vetëm raport për banesat sociale? Se me sa munda ta shoh unë, më shumë flitet për banesat sociale por nuk është edhe për kategorinë tjetër.

**Fadil Gashi, Kryesues:** Ne edhe ne seancën e kaluar e kemi pasur, neve na ka ardhur një regjistër me të gjithë edhe banesat sociale edhe zyrtare, na ka ardhur edhe një regjistër po në seance jemi marr vesh se nuk ka pasur të bëjë me zyrtarë publik ai regjistër, edhe ne ju kemi referuar faljes së qirasë për gjithë ata që janë në shfrytëzim të banesave sociale duke i përjashtuar gjithë zyrtarët publik dhe që janë kategoritë të dala nga lufta, kështu e kemi marr vendimin me i liru prej qirasë veç për ata që kanë status social, për këta zyrtarë publik nuk ka. Për zyrtarë publik jemi duke folur sot, njëri prej dy rekomandimeve se njëri është se tash është ligji, nuk ka pasur po i ka skaduar afati, tash n'mars e kanë bërë plotësim-ndryshimin e ligjit, e kanë shtuar afatin edhe komuna për një pjesë banesës edhe tash për këta zyrtarë publik është me rekomandu me fillu procedurën, me autorizu kryetarin si autoritetin kryesor ekzekutiv të komunës edhe sipas ligjit me fillu procedurën e privatizimit të tyre, kush ka të drejtë, te rastet sociale te këto që kanë status social me vazhduar kontratën për gjithë ata banues, ata përfitues të cilët i plotësojnë prapë kriteret si banorë të atyre banesave sociale në asistencë sociale me i vazhduar kontratat, këtu ki rekomandim, paska rekomandim me jua hekë krejt me jua marr shfrytëzimin, po le të bisedojnë edhe me ata edhe njëherë edhe vërtet nëse ata kanë hekë dorë komuna i merr në menaxhim jua jep dikujt nëse ka nevojë është procedurë tjetër. Po, urdhëro, Tunë ?

**Tunë Dedaj:** Po Kryesues, unë për çdo gjë pajtohem me atë që e thatë ju, unë pajtohem që është mirë të shkojë në atë mënyrë.

**Fadil Gashi, Kryesues:** Faleminderit Tunë, urdhëro Mendehie?

**Mendehie Duraku:** Unë vetëm desha ta di, a ka njerëz që e kanë statusin zyrtar e banesa është në emër të statusit social dhe a shfrytëzohet nga ai zyrtari apo nga ai me status social?

**Fadil Gashi, Kryesues:** Tash nëse mund ta jap një përgjigje! Shiqo, ndarja e banesave kur është bërë në 2009-ten nëse nuk gabo, është bërë për zyrtarët publik, ai tekstualisht thotë kështu. Ai nuk është rast social, vetëm ky është dallimi që unë po e përmendi zyrtarë publik edhe ata nuk trajtohen si raste sociale. Raste sociale janë krejt tjera, në raste sociale mund të ketë zyrtar që punon por statusi i banesës nuk është zyrtar, statusi i banesës është sociale, a e plotëson kriterin a se plotëson, se ai i banesës sociale realisht me m'pyet mua nuk duhet ta plotësojë kriterin social nëse ti je duke punuar diku, ju keni të drejtë por banesa ku e ka marr ai, statusi i banesës është banesë sociale. Unë po flas për objektin, objektet ku janë për zyrtarë publik, statusin e ka kështu për zyrtarë publik edhe aty kanë hyrë: mësuesi,shërbyesi civil, anëtarë të Kuvendit etj, por statusi i banesave është kështu, zyrtarë publik, atje është banesë sociale. Për këtë po mundohem që tua kërkojë prej të gjithëve që mos t'i përziemi këto dyja, sepse nuk shkojnë bashkë, nuk janë të njëjtë. Urdhëro, Tunë?

**Tunë Dedaj:** Është mirë me e pa, nëse një zyrtar publik është shfrytëzues i banesës sociale, me bisedu me të, atij me ju marr banesa e me ju dhanë njerëzve që kanë nevojë, se unë e di që ka shumë familje që kanë nevojë për banesë dhe që kanë raste sociale, e banesa nuk kanë.

**Fadil Gashi, Kryesues:** Unë veç edhe një sqarim nëse mund ta bëj, rekomandimi ynë pikërisht e ka këtë që po e kërkon, ne duhet me ja dhanë dritën jeshile kryetarit, ta fillojë procedurën e nënshkrimit të kontratës, gjatë nënshkrimit të kontratës nëse ju referohemi ligjeve dhe akteve tjera nënligjore për kategoritë sociale, aty janë kriteret, kush i plotëson kriteret si kategori sociale edhe unë besoj që aty zyrtari që është duke punuar nuk e plotëson. Tash është në përgjegjësinë e kryetarit a guxon ta nënshkruaj atë kontratë apo s'guxon, se di a jemi të qartë, ne jemi duke e ngarkuar me përgjegjësi kryetarin, ne nuk jemi duke i dhënë ndonjë privilegj, edhe jo rastësisht afati i tyre ju vazhdohet për nga një vit, varësisht thotë prej ndryshimit të gjendjes ekonomike që dallon prej këtyre zyrtarëve publik se i kanë banesat, atyre nuk ju thotë kështu, e te ta varësisht prej ndryshimit të gjendjes ekonomike, atyre ju vazhdohet veç për nga një vit, ka qenë vetëm për nga dy vite më herët, prandaj po them përgjegjësia bie mbi kryetarin kur t'fillojë që t'i nënshkruajë kontratat, a si kriter besoj që nuk bën të shkelet aty ku t'fillon me u nënshkru kontrata edhe kriteret janë në kontratë. Urdhëro Bledar!

**Bledar Berisha:** Neve në seancën e Komitetit të kaluar na është paraqitur dmth lista për shfrytëzues, por tash nga kjo temë dolëm në temën që me shqyrtu edhe me shiku kush është shfrytëzues, posedues ose pronari i banesës. Këtu është mirë të themelohet një komision ekstra për me ditë se për me ja obliguar të drejtën e lirim nga qiraja, është mirë të dimë kush është pronar ose shfrytëzues i banesës që tash prej atij problemi dmth prej të drejtës lirim nga qiraja, neve po na del problem tjetër që është shumë më kryesor se kjo, se kush është shfrytëzues ose pronar i një prone të paluajtshme, faleminderit!

**Fadil Gashi, Kryesues:** Ne për lirim nga qiraja veç e kemi marr vendimin, seancën e kaluar i kemi liruar rastet sociale. Sot është diçka tjetër, sot po kërkohet të fillojë procedura sepse s'kanë

kontrata, veç një pjesë e vogël kanë kontrata sepse ju kanë skaduar, po flasim që ne të kërkojmë nga kryetari që të fillojë procedurën e nënshkrimit të kontratave me ata shfrytëzues. Pra, kontrata nuk kanë edhe janë duke i shfrytëzuar pa kontratë, tash kush është duke i shfrytëzuar? Prandaj ka dalë nga seanca e fundit për të ditur sepse këtu dilemat kanë dalë në seancë të fundit, kush i shfrytëzon ,a janë ata apo dikush tjetër duke i shfrytëzuar, prandaj e kemi tash këtë raportin e ri nga seanca e kaluar dhe i ka determinuar kështu si i keni parë edhe po i shihni rekomandimet. A ka dikush tjetër, nëse s'ka a mund t'i rekomandojmë për Kuvend të dyja edhe për raste sociale edhe për këta të zyrtarëve , kush është për ?

**Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të kërkesës, me 7 vota PËR, rekomandoi që kërkesa të kalojë për shqyrtim në Kuvend. Të fillohet me vazhdimin e kontratave me qiramarrësit të cilët i plotësojnë kushtet për shfrytëzimin e banesave të cilat janë pronë e komunës dhe të ndërprejnë kontratën për ata të cilët nuk i plotësojnë kushtet. Ndërsa qiramarrësit të cilët janë zyrtarë publik dhe shfrytëzojnë banesat të cilat janë pronë e komunës të mund të fillojnë procedurat për blerjen e banesave.**

**Fadil Gashi, Kryesues:** Nëse ka dikush, diçka urdhëroni?

-Pasi askush nuk mori fjalën, kryesuesi, falënderoj të gjithë për pjesëmarrje dhe angazhim me kaq mbylli mbledhjen e rregullt të KPF-së!

**Procesmbajtësja,  
Monika Palushi**



**KRYESUESI,  
Fadil Gashi**